



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:370238

Datë: 24.03.2025

Numri i dokumentit: 07031440

C.nr.4851/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje me gjyqtarin Skender Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.P. nga Mitrovica të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Valdrin Islami, avokat me seli në Mitrovicë, kundër të paditurës KM - DKA , të cilën sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Lirim Zeka, avokat me seli në Prishtinë, me objekt kontesti “*Kompensim i të ardhurave nga marrëdhënia e punës*”, jashtë seance gjyqësore, datën 24.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M
NË BAZË TË POHIMIT

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditëses S.P. nga Komuna e Mitrovicës, e bazuar.
- II. DETYROHET e paditura KM - DKA, që paditësve t’ia paguajë kompensimin në emër të kompensimit të inflacionit në pagë për periudhën nga data 29.06.2022 deri më 31.10.2022, në lartësi prej 11.6% të pagës bazë, t’ia paguajë shumën e tërësishme prej 241.10 euro për 4 muaj pune me kamatë ligjore prej 8 për qind, e cila do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë në gjykatë (24.12.2024) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto (borxhin kryesor dhe kamatën ligjore) në afatin prej 7 (*shtatë*) ditësh, nën kërcënim të përmbarimit.
- III. OBLIGOHET e paditura K.M-DKA, t’ia paguajnë paditëses shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej (98) nëntëdhjetë e tetë euro, të gjitha në afat prej 7 (*shtatë*) ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja S.P. nga Mitrovica, nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë (24.12.2024), pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës K.M-DKA, me objekt kontesti *“kompensimin i të ardhurave nga marrëdhënia e punës”*.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë, fillimisht vërejtë se padia është përpiluar në tërësi në përputhje me dispozitën nga neni 253, lidhur me nenin 99 të LPK, pas plotësimit të kushteve ligjore, të njëjtën (padinë me dokumentet e bashkangjitura në të), më Aktvendimin që mbanë shenjen C.nr.4851/2024, të datës 19.02.2025, e detyron të paditurën që në afatin prej 15 ditësh të paraqesë përgjigje në padi, nën kërcënimin e pasojave juridike. Tutje, e paditura më parashtrësën e datës 13.03.2025, (përgjigjen në padi) e ka pohuar kërkesëpadinë e paditësve për sa i përket inflacionit në pagë për periudhën kohore 01.01.2021 e deri me 31.10.2022. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pas pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurit, konstatoi se në këtë çështje kontestimore kemi të bëjmë me kërkesë me të cilën palët mund të disponojnë lirshëm, në kuptim të nenit 148 paragrafi 1 të LPK, me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit)”* vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në pikën II të dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, duke u bazuar në dispozitën e nenit 7 paragrafi 1 të LPK, ku shprehimisht thuhet *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, ndërsa me dispozitën e nenit 319 paragrafi 1 dhe 2, te po te njëjtë ligj shprehimisht thuhet *“Secila nga palët ndergjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, ku të provuarit përfshihen në të gjitha faktet që janë të rëndësishme për dhënien e vendimit”*.

Lidhur me kamatën ligjore të kërkuar nga paditësi, duke qenë se e paditura, ka rënë në vonesë lidhur me pagesën e borxhit të krijuar, gjykata ka vendosur që kamatë vonesa të jetë prej 8%, duke u bazuar në nenin bazuar në nenin 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit padisë në gjykatë (24.12.2024), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën

të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur nga paraqitja e padisë është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452 paragrafi 1 të LPK, sipas të cilit pala e cila e humb kontestin tërësisht ka për detyrë që, palës kundërshtare, t'ia kompensojë shpenzimet gjyqësore. Në rastin konkret pala e paditur ka për obligim që paditëses të ia paguaj shpenzimet procedurale në emër të përpilimit të padisë, në shumën prej 78 euro, dhe në emër të taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë si dhe duke u bazuar në nenin 148 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

C.nr.4851/2024, datë 24.03.2025

G J Y Q T A R I

Skender Shala

UDHEZIM MBI MJETIN JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkak se deklarata e pohimit, është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit, në afat prej 7 (shtatë) ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.